

## Vårdval Halland

Vårdval Halland do të thotë që ju mund të zgjidhni qendrën shëndetësore që dëshironi t'i drejtoheni kur keni nevojë për kujdes shëndetësor. Ju mund të zgjidhni gjithashtu edhe disa klinika të specializuara. Të gjitha qendrat shëndetësore dhe klinikat e specializuara të përfshira nga Vårdval Halland janë të kontrolluara dhe të miratuara nga Rajoni i Halland.

### Zgjidhni qendrën tuaj shëndetësore

Në Halland ju mund të zgjidhni se në cilën qendër shëndetësore të paraqiteni kur keni nevojë për kujdes. Mund të zgjidhni midis qendrave shëndetësore të cilat janë private apo ato që drejtohen nga Rajoni i Halland. Qendra shëndetësore duhet t'ju sigurojë kujdes shëndetësor dhe mjekësor që nuk kërkon burimet e spitalit. Duhet gjithashtu që t'ju drejtojë tek specialisti i duhur dhe kujdesi psikiatrik.

Zgjedhja juaj përfshin një marrëveshje midis jush dhe qendrës tuaj shëndetësore. Qendra shëndetësore që ju zgjidhni duhet të jetë patjetër zgjedhja juaj e parë kur keni nevojë për kujdes. Ju mund t'i ndryshoni qendrat shëndetësore në çdo kohë.

Pjesëtarë të ndryshëm të një familjeje mund të zgjedhin të frekuentojnë qendra shëndetësore të ndryshme. Prindi apo kujdestari i një fëmije zgjedh qendrën shëndetësore për fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç.

### Si ta zgjidhni qendrën shëndetësore

- Plotësoni formularin për zgjedhjen e kujdesit dhe dërgojani qendrës shëndetësore të cilës dëshironi t'i përkisni. Qendra shëndetësore do t'ju kontaktojë brenda 14 ditëve për t'ju thënë se kur mund t'ju pranojë si pacient.

Përpara se të vendosni, mund të mësoni më tepër për fokusin e qendrave të ndryshme shëndetësore dhe shërbimet që ato ofrojnë. Dëshironi të regjistroheni në një qendër shëndetësore pranë shtëpisë apo pranë vendit ku punoni? Cilat janë oraret e tyre të punës? Çfarë aftësish të specializuara kanë?

### Zgjidhni klinikën e specializuar

Në Halland ju mund të zgjidhni kujdes të specializuar për disa diagnoza brenda kujdesit për lëkurën dhe psikiatrinë për të rriturit. Zgjedhja në më shumë specialitete do të ofrohet në të ardhmen.

Mund të kontaktoni me një klinikë të specializuar kur është vërtetuar se keni nevojë për kujdes të specializuar. Në shumicën e rasteve këtë konfirmim do ta bëjë një mjek në qendrën tuaj shëndetësore dhe do t'ju referojë në klinikën e specializuar. Mundet gjithashtu që të kontaktoni vetë me një klinikë të specializuar, dhe të shkruani një referim për veten tuaj.

Ju mund të zgjidhni nga klinikat e specializuara të cilat janë private apo të drejtuara nga Rajoni i Halland, dhe të paguani tarifën e njëjtë të pacientit, pavarësisht nëse klinika është publike apo private.

Në sistemin e Vårdval përfshihet kujdesi i specializuar për diagnozat në vijim:

Kujdesi për lëkurën: Ekzema, psoriaza, të kruarat, investigimi i njollave të lindjes  
Psikiatra për të rriturit: Trajtimi i depresionit, çrregullimi bipolar dhe çrregullimet neuropsikiatrike ADHD dhe ADD.

### **Si të zgjidhni një klinikë të specializuar**

- Zgjidhni një klinikë vetëm kur të keni nevojë për një të tillë. Ju mund të referoheni nga mjeku në qendrën shëndetësore ose mund të kontaktoni me një nga klinikat e kujdesit të specializuar që janë pjesë e vetë Vårdval Halland.
- Zgjedhja juaj vlen për periudhën kur jeni të sëmurë apo duke u trajtuar. Ju keni të drejtën që të zgjidhni një klinikë të re, si dhe kur të dëshironi.
- Ju paguani të njëjtën tarifë të pacientit si në rastin kur klinika që zgjidhni drejtohet privatisht, ashtu edhe kur drejtohet nga Rajoni i Halland.

Informacione për klinikat prej të cilave mund të zgjidhni mund të gjenden në [www.1177.se/varldval](http://www.1177.se/varldval).

